



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 517/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Besianë, paraqitur kundër Fidan Sinani, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Besianë.

Arsyetim

PZAP-i ka pranuar një ankesë më datë 04.11.2013, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën ankesë pretendohet se më datë 03.11.2013 në ora 16:04 në vendvotimin 08R Q.V 1824e sipas informatës së dhënë nga kryesuesja Elena Stublla shkelja në procesin zgjedhor ka ndodh kur Fidan(Ismet) Sinani i lindur me 09.09.1991 në vendvotim është prezantuar si komisioner i cili kishte për qëllim që të votonte, i njëjti është ndaluar nga kontrollori i rreshtit Flakron Sheholli nga PDK-ja. Sipas parashtruesit të ankesës theksohet se kur iu është kërkuar të prezantoj dëshminë se a është komisioner, personi në fjalë ka treguar bexhin e vëzhguesit. Parashtruesi i ankesës potencon se me këtë rast është marrë edhe policia, për deklaram të rrejshëm.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 LZP-së, parashihet se: *“Mund te apelothen vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikojë cilindo nga vendimet marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*.

Pretendimet ankimore të palës ankuese, se në Vendvotimin 08R Q.V1824 ka pasur parregullsi gjatë procesit zgjedhor nga personi i cekur më lartë, PZAP-i i konsideron se janë të pabazuara dhe të pa argumentuara sepse nga dëshmitë e ofruara nuk janë dëshmi bindëse për parregullsinë e pretenduar dhe nuk janë të mjaftueshëm për të vërtetuar kryesin e supozuar të shkeljes. PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i pa argumentuar në prova relevante, andaj në kuptim të nenin 3.6 pika c) të Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 517/2013 më datën 07.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala**



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.